

Gjatë viteve 1944-1990 Shqipëria ishte një sistem politik njëpartiak, stalinist dhe unik në mënyrën agresive të ushtrimit të pushtetit. Ai ishte vendi i vetëm refuzues i procesit të Helsinkit dhe me Kushtetutë, i ndalimit të besimit në Zot. Konceptet e të drejtave të njeriut de facto ishin dhe mbetën të huaja, të rrezikshme dhe të ndëshkueshme me ligj. Me pushtete të njësuara nën pushtetin suprem të PPSH, regjimi ia doli për 46 vjet të krijojë një kulturë nënshtrimi strukturor dhe ideologjik të ushtruar përmes propagandës, dhunës dhe frikësimit... Çdo libër që përshkruan jetën nën këto regjime, që tregon kontrollin total, censurën, paranojën, policinë sekrete, kampet e përcandrimit, kampet e punës, zhvendosjet dhe ekzekutimet; çdo libër që nxjerr në shesh kultet personaliteti që i fuqizojnë këto regjime, - çdo vepër e fillë është një thesar. Ky libër rrëfen fiparet, ideologjinë dhe praktikën e Shqipërisë komuniste ndaj duhet të lexohet jo vetëm nga politologët, historianët dhe studentët e tyre, por nga çdo qytetar, në mënyrë që ne të mos t'u rikthehemi tmerreve të së shkuarës.

EDITUAR NGA - Afrim KRASNIQI, Vëra STOJAROVÁ



SHTETI DHE SHOQËRIA NË SHQIPËRINË KOMUNISTE 1945-1990

EDITUAR NGA
Afrim KRASNIQI
Vëra STOJAROVÁ

Botimi është kontribut profesional i disa studiuesve dhe përmbledh i fusha e këndvështrime të ndryshme mbi shtetin e shoqërinë gjatë periudhës 1945-1990 në Shqipëri. Botimi u mbështet nga programi TRANSITION i MPJ të Republikës së Çekisë.

SHTETI DHE SHOQËRIA NË SHQIPËRINË KOMUNISTE 1945-1990



Instituti i Studimeve Politike
www.isp.com.al

TRANSITION
Ministry of Foreign Affairs of the Czech Republic



Embassy of the Czech Republic
in Tirana

ISBN 978-9928-4592-8-2

***SHTETI DHE SHOQËRIA
NË SHQIPËRINË KOMUNISTE***

1945-1990

EDITUAR

nga

***Afrim KRASNIQI
Vera STOJAROVA***

Botimi është realizuar nga Instituti i Studimeve Politike (ISP) mbështetur nga programi “Transition”, i Ministrisë së Jashtme të Republikës së Çekisë.

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve.



TRANSITION
Ministry of Foreign Affairs of the Czech Republic



Embassy of the Czech Republic
in Tirana

Redaktorë

Nevila Zenelaj

Gëzim Zilja

Kopertina

M&P Studio

Shtypur në shtyshkronjën

EMAL

© Copyright - Instituti i Studimeve Politike

ISBN: 978-9928-4592-8-2

Tiranë 2020

web: www.isp.com.al

Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

PËRMBAJTJA

JETA ËSHTË TJETËRKUND – TË JETOSH (JO VETËM) NË SHQIPËRINË KOMUNISTE Vera STOJAROVA	5
HYRJE MBI BOTIMIN	10
TOTALITARIZMI SHQIPTAR SI RAST <i>SUI GENERIS</i> NË ISH-EUROPËN LINDORE Illir KALEMAJ	17
IDEOLOGJIA, SHTETI DHE E DREJTA NË SHQIPËRI (1945-1990) Irena NIKAJ	37
SISTEMI QEVERISËS DHE ASPEKTE TË PËRFAQËSIMIT POLITIK 1945-1990 Afrim KRASNIQI	53
LIRI “TË BURGOSURA”: LIRITË DHE TË DREJTAT TË NJERIUT GJATË VITEVE TË “DIKTATURËS SË PROLETARIATIT” NË SHQIPËRI Sonila BOÇI	84
CENSURA DHE SHKRIMTARËT SHQIPTARË NË DIKTATURË Lazër STANI	112
KRIMET KUNDËR SHTETIT NË LEGJISLACIONIN E SHTETIT KOMUNIST Kastriot DERVISHI	124

POLITIKA E PPSH PËR MBYLLJEN E OBJEKTEVE TË KULTIT DHE NDALIMIN E FESË (1944-1967)	
Hasan BELLO	149
PROCESI I SOVJETIZIMIT TË SHQIPËRISË (1945-1953)	
Dorian KOÇI	175
MARRËDHENIET E REGJIMIT TË ENVER HOXHËS ME SHBA DHE MBRETËRINË E BASHKUAR (TETOR 1944-DHJETOR 1946)	
Romeo GURAKUQI	202
NDËRTIMI I “NJERIUT TË RI” NË SHQIPËRI	
Alkida LUSHAJ	236
PROBLEMET DHE PENGESAT E HASURA NË POLITIKËN E INDUSTRIALIZIMIT TË VENDIT	
Hasan BANJA	250

JETA ËSHTË TJETËRKUND – TË JETOSH (JO VETËM) NË SHQIPËRINË KOMUNISTE

Vera STOJAROVA*

Sa herë më bie detyra t'u shpjegoj studentëve të mi epokën komuniste, gjithmonë pyes veten – nga t'ia filloj? Të gjithë kanë lindur shumë kohë pas revolucionit të vitit 1989, shumica pas fillimit të mijëvjeçarit të ri, ndaj për ta është e vështirë të përfytyrojnë imazhe reale të jetës në epokën komuniste.

Ndonjëherë rrëfimin e filloj me kujtimet e gjyshes sime. Menjëherë pas lindjes së fëmijës së saj të tretë, burri i saj u burgos. Ai kishte refuzuar të hiqte dorë nga prona e tij, kishte refuzuar shtetëzimin. Ndaj, kur dua të risjell atë kohë në kujtesë, përpiqem ta vendos veten në vendin e saj. Imagjinoj se jam nënë e tre fëmijëve për të cilët kujdesem ndërsa drejtoj një fermë të madhe me fusha dhe pyje, dhjetëra lopë, derra, pula dhe rosa. Gjyshja nuk pati kurrë kohë t'i ushqente fëmijët me gjë. Në vend të qumështit të gjirit, ata ushqeheshin me lëng orizi dhe hurrë, ndërsa babai i tyre, gjyshi im, u kalb në burg. Si fëmijë kulaku, askush prej fëmijëve nuk pati mundësinë të studionte në universitet apo edhe në shkollën e mesme. Kur isha me gjyshen, të dielave shkonim në kishë, por e kisha të ndaluar të flisja për këtë gjë në shkollë. Ende më kujtohen marshimet përkujtimore për Revolucionin e Tetorit 1917, marshimet për të festuar fundin e Luftës

* Věra Stojarová është Professore e Asociuar (2018) në Universitetin Masaryk, në Brno, Republika e Çekisë. Ajo diplomuar për shkencat politike në Palacky University (Ceki) dhe ka doktoruar gjithashtu në shkencat politike. Stojarová është eksperte kërkimore në fushën e sigurisë dhe për zhvillimet politike për Ballkanin dhe Amerikanë Latine. Ajo ka një përvojë të gjatë angazhimesh ndërkombëtare, përfshirë edhe projekte studimore mbi Shqipërinë dhe angazhime bashkëpunimi me universitetet shqiptare. Stojarová është autore e një numri të madh artikujsh shkencorë mbi Ballkanin Perëndimor, zhvillimet politike, partitë dhe populizmin, fenë dhe sigurinë.

së Dytë Botërore dhe mënyrën se si na duhej të dekoronim dritaret me flamuj çekoslovakë dhe sovjetikë. Ende e urrej radhën para dyqaneve. Fëmijëria ime ishte e gjitha një radhë e gjatë – radhë për banane, për portokall, për qitro, madje edhe letër higjienike. Pecetat higjienike zor se gjendeshin nëpër rafte.

Mbaj mend frikën që ndjeja pas Çernobilit, kur askush nuk e dinte të vërtetën dhe të gjithë prisnin më të keqen. Më kujtohet një mikja ime, nëna e së cilës nxirrte jashtë më shumë para sesa lejohej duke i qepur ato në fustane për t'i shpëtuar doganave hungareze. Më kujtohet entuziazmi i saj kur arriti të blinte vajzës së saj të vogël disa palë mbathje që kishin të qëndisura ditët e javës, një artikull i padisponueshëm në atë kohë në Çekoslovakë. Më kujtohet kur, pas të gjitha halleve dhe problemeve për të rezervuar pushimet në Jugosllavi (pasaporta, e ashtuquajtura leje e daljes, kërkesa për valutë të huaj, deklarata doganore, viza, dorëzimi i broshurës ushtarake), një fqinj erdhi për të na pyetur nëse po largoheshim përgjithmonë nga vendi. Dhe pastaj kujtoj kënaqësinë e Nutella-s time të parë gjatë atyre pushimeve në plazhin kroat.

Më kujtohet tronditja që ndjeva në vizitën time të parë në Bashkimin Sovjetik. Gjatë fëmijërisë sime kisha mësuar në shkollë për këtë vend të shkëlqyeshëm ku e nesërmja kishte ardhur që dje dhe arritjet e mëdha ishin diçka e përditshme. Në vend të kësaj mrekullie, ajo që gjeta ishte një vend ku mezi arrije të blije bukë. Pas Revolucionit të kadifenjtë, kur kufijtë u hapën, kapitalizmi na përqafoi plotësisht dhe me pasion. McDonalds na solli një kulturë të tualeteve të pastra dhe ushqimit të shpejtë. Papritmas u përballëm me zgjedhje - shumë prej tyre. Jeta u bë më e shpejtë dhe më e vrullshme se sa kish qenë nën zgjedhën komuniste. Shumë njerëz u pushuan nga puna dhe papunësia kaloi nga zero në dhjetë përqind; njerëzit krijuan bizneset e tyre, prona e konfiskuar iu kthye pronarëve dhe privatizimi filloi të ecte përpara në mënyra të ndryshme.

Filluan të shfaqen parti të reja politike dhe njerëzit u sulën t'i votonin. Këto ndryshime nuk ishin të kufizuara në vendin tim. Më kujtohet vizita ime e parë në Check Point Charlie gjatë studimeve të mia

në Berlin, ku u njoha me shumë mënyra për të dalë nga një vend ku nuk dëshiron më të jetosh. Mësova se si njerëzit kacavirreshin në atë mur, gërmonin tunele dhe fshiheshin në bagazhin e veturave; dëgjova se si u qëlluan dhe u vranë duke u përpjekur të kalonin telat me gjemba, si ata u hodhën nga dritaret e shtëpive në Berlinin Perëndimor, sesi ata notuan nëpër Kanalin Teltow, si fluturuan me balona me ajër të nxehtë të bëra në shtëpi ose aeroplanë ultra të lehtë. U njoha me paranojën duke parë filmin gjerman “Das Leben der Anderen”, teksa imagjinoja veten nën mbikëqyrje njëzetekatër orë në ditë. Kur lexova librin 1984 të George Orwell, rikujtova propagandën e kohës së rinisë.

Më tërhiqte më shumë më tepër Lindja sesa Perëndimi. Kësisoj u gjenda në Shqipëri për dy javë për ndihmuar refugjatët kosovarë. Shqipëria ishte për mua një vend i largët, një vend të cilin e njihja vetëm nga edicioni në gjuhën çeke i Radio Tiranës misterioze, e cila na kishte informuar se i vetmi vend me të vërtetë komunist i botës gjendej në Shqipëri. E vetmja gjë konkrete që dija për Shqipërinë ishte se ajo kishte dalë nga Traktati i Varshavës në shenjë proteste ndaj pushtimit të Çekoslovakisë nga vendet e Paktit në vitin 1968. Në Shqipëri gjeta një vend të bukur plot njerëz të mirë. Menjëherë u dashurova me Shqipërinë dhe shqiptarët. Më vonë mësova se regjimi komunist në Çekoslovakia ishte parajsë në krahasim me atë në Shqipëri. Mora informacion për Sigurimin. Thuhet se çdo i katërt burrë ishte pjesë e Sigurimit. Në këtë situatë, kujt mund ti besonit në të vërtetë jo vetëm rrethet miqësore, por edhe brenda rrethit të familjes tuaj të ngushtë? A mund ti besonit burrit tuaj, vajzës suaj, djalit tuaj?

Në mënyrë të frikshme, motoja e Sigurimit – “Për Njerëzit, Me Njerëzit” - nënkuptonte saktësisht atë që thoshte. Në Shqipëri u njoha me shtetin e parë ateist në botë, me prishjen e kishave dhe xhamive, djegien e Biblave dhe Kuranëve – situata ekstreme të cilat Çekoslovakia nuk i kishte provuar kurrë. Pashë bunkerë prej betoni të ngulur çdo dy metra - një shenjë e paranojës totale të regjimit dhe militarizimit të plotë të shoqërisë, një pamje e cila e huaj për edukimin tim. Përjetova një vend të varfër të mbetur pas çdo kombi tjetër evropian për sa i përket

infrastrukturës, teknologjisë, zhvillimit industrial dhe planifikimit urban. Sytë e mi u hapën edhe në lidhje lirine relative për të udhëtuar që kishim patur në Çekosllovakia. Ne ishim të kufizuar në Evropën Lindore, është e vërtetë, por shqiptarët u përballën me kufizime të udhëtimit edhe vetë brenda kufijve të tyre. Mbaj mend që takova njerëz që quheshin Marenglen dhe nuk munda të gjeja ndonjë shprehje të ngjashme të besnikërisë së thellë ndaj marksizmit në vendin tim. Lexova librat e Ismail Kadaresë “Vajza në Mërgim” dhe “Piramida”, dhe nuk mund ta harroj shijen e paranojës totale, të pashoqe e të pakrahasueshme me asnjë vend të Evropës Lindore përveç Rumanisë.

Më vonë pashë piramidën në Tiranë, e cila tërhiqte vëmendjen e turistëve nga e gjithë bota për të kaluarën e Shqipërisë. Përsa u përket viktimave të komunizmit, as Shqipëria as Çekosllovakia nuk renditeshin ndër vendet me numrin më të lartë të tyre. Numri i viktimave në to llogaritej në dhjetëra mijëra, ndërsa regjimet më brutale - Republika Popullore e Kinës, BRSS, Kamboxhia – i numërojnë me miliona. Hipokrizia e disa prej këtyre regjimeve pasqyrohet në kultet e tyre të personalitetit, pompozitetin e tyre dhe dyqanet e veçanta të hapura për zyrtarët e partisë, ndërsa në të njëjtën kohë njerëzit e thjeshtë mjaftoheshin me ushqimin e racionuar. Buka, qumështi, gjalpi dhe ushqimet e tjera ndaheshin me racione në pjesën më të madhe të Rumanisë deri në 1989. Regjimi i shëmtuar rumun tregoi anën e tij të errët në epideminë e AIDS-it në fund të viteve 1980, e cila u përkeqësua pas refuzimit të autoriteteve për të pranuar ekzistencën e sëmundjes.

Gjithashtu regjimi nuk lejoi testimin e HIV-it. Rumania nisi të njihej pas vitit 1989 si vendi i duhur për të blerë fëmijë. Shumë fëmijë ishin braktisur në rrugë; të tjerët kishin nëna të dëshpëruara të gatshme t'i shisnin në mënyrë që fëmijët të mbijetonin dhe të shmangnin taksën e vendosur për çdo grua, të martuar apo beqare, e cila arriti moshën 25 vjeç pa fëmijë. Ndalimi i kontracepsionit dhe abortit ilustron mirë në filmin rumun “Katër muaj, tre javë dhe dy ditë”.

Udhëtimet e sotme nëpër Evropën Lindore na tregojnë se tashmë shumë pak relike të të kaluarës komuniste kanë mbetur për t'u parë. Bunkerët e Shqipërisë janë zhdukur pothuajse të gjithë; statujat e Marksit, Leninit dhe Stalinit janë rrëzuar; Perdja e Hekurt ka rënë; pjesa më e madhe e Evropës Lindore tani është në BE apo edhe në Zonën Shengen. Qëllon që nuk kuptohet momenti kur kalon një kufi mes dy shteteve. Studentët e Evropës Lindore studiojnë në universitetet perëndimore, studentët perëndimorë në ato lindorë. Dyqanet janë plot mallra, xhamitë dhe kishat janë rindërtuar dhe rinovuar, dhe nëse dikush dëshiron të shohë pak nga e kaluara komuniste, ajo tani gjendet vetëm në muze (Check Point Charlie, Pallati i Çausheikut, Shtëpia e Gjetheve, BunkArt ose ndonjë nga bunkerët e gjerë të udhëheqësve komunistë lokalë) ose në librat kushtuar asaj kohe në historinë tonë kolektive.

Historia est magistra vitae - na duhet të mësojmë nga e kaluara për të shmangur përsëritjen e gabimeve tona, kjo është një klishe që të gjithë kemi mësuar në shkollë. Por historia është plot me gabime të tilla të përsëritura. Ne i bëjmë ato pa pushim. Jo pak njerëz bien pre e ideve jo liberale, të shumtë janë ata që besojnë se kombi i tyre është kombi i përzgjedhur, ca të tjerë zbulojnë me një ceremoni të shkëlqyer një statujë të Karl Marksit. Ne kurrë nuk mund ta ritregojmë sa duhet realitetin e regjimeve komuniste. Çdo libër që përshkruan jetën nën këto regjime, që tregon kontrollin total, censurën, paranojën; policinë sekrete, kampet e përqendrimit, kampet e punës, zhvendosjet dhe ekzekutimet; çdo libër që nxjerr në shesh kultet e personalitetit që i fuqizojnë këto regjime: çdo vepër e tillë është një thesar. Unë e mirëpres këtë botim. Ai rrëfen ideologjinë dhe praktikën e Shqipërisë komuniste dhe duhet të lexohet jo vetëm nga politologët dhe studentët e tyre, por nga çdo qytetar, në mënyrë që ne të mos t'u rikthehemi tmerreve të së shkuarës.

HYRJE MBI BOTIMIN

Dhjetori i vitit 2020 shënon 30 vjetorin dhe fundin e sistemit komunist dhe vendosjes së sistemit shumëpartiak në Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe Shqipëria ka kaluar në një proces të gjatë dhe kompleks transformimi dhe reformash, në përpjekje të brishta për të ndërtuar sistemin e ri të bazuar në shtetin e së drejtës, ekonominë e tregut të lirë, integrimin euroatlantik dhe demokracinë funksionale. Pavarësisht raportit disproporcional midis pritshmërive, mundësive dhe arritjeve, Shqipëria e sotme nuk gjen ngjashmëri me Shqipërinë e përpara 1990. Janë dy sisteme të ndryshme, dy shoqëri të ndryshme, dy realitete e botë të ndryshme. Mund të ketë zhgënjime, nostalgji, ruajtje të miteve të rreme, përsëritje të gabimeve dhe metodave në mendim e veprim, por gjithsesi vlerat e sotme të lirisë, demokracisë dhe shtetit të së drejtës përbëjnë dallimin e madh.

Me të drejtë analizat kritike të bilancit të tranzicionit e ndërtojnë argumentin kryesor në trashëgiminë negative dhe ndikimeve të së kaluarës në formatimin e sistemit të ri. E kaluara shihet si pengesë jo vetëm në progresin e brishtë të formësimit demokratik të shoqërisë, por edhe në aspektin ekonomik, social, si dhe në mënyrën sesi janë ndërtuar e funksionojnë elitat politike, proceset vendimmarrëse dhe raportet midis individit e pushtetit / shtetit. Një shoqëri që nuk arrin të dialogojë mbi të kaluarën e saj, të përballet me gabimet e veta dhe të ndahet prej saj me drejtësi e integritet, rrezikon të mbetet peng i vetvetes dhe bashkëfajësisë, si dhe ia kufizon vetes vizionin, energjinë dhe kurajën për të ndërtuar një të ardhshme në prosperitet e demokraci funksionale.

Shqipëria nuk e ka bërë ndarjen institucionale me të kaluarën, Shqipëria bashkëjeton me të kaluarën dhe në disa elementë, e përdorë atë në funksion të nevojave të sotme. Në dallim nga shumica e vendeve ish-komuniste Shqipëria nuk pati çlirim e prezencë nga një forcë e huaj ushtarake, nuk pati gjatë gjithë periudhës një regjim kukull të emëruar apo

mbështetur nga jashtë, siç nuk pati periudha reflektimi, korrektimi, moderacioni apo tolerance ndaj mendimit ndryshe, besimit, lëvizjeve qytetare apo elita që rrezikojnë me kritikën dhe integritetin e tyre. Në funksion të vendosjes dhe më pas të mbijetesës, regjimi eksperimentoi me varësinë jugosllave, sovjetike e kineze për të kaluar më pas në një vetizolim hermetik nga Lindja dhe Perëndimi. Shqipëria ishte vendi i vetëm refuzues i procesit të Helsinkit dhe me Kushtetutë, i ndalimit të besimit në Zot. Koncepti i të drejtave të njeriut, i pronës, i lirisë së mendimit, i besimit, i lëvizjes, i dinjitetit qytetar, i korrespondencës apo i të drejtave sociale, i lëvizjes apo i meritës, i zgjedhjes dhe i institucionit në familje, etj, ishin dhe mbetën koncepte të huaja, të ndaluara, armiqësore dhe të ndëshkueshme me ligj. Njësimi i pushteteve në një pikë referimi, zëvendësimi i nocionit të Kushtetutës dhe ligjit me porosinë dhe urdhrin politik të diktatorit apo Byrosë Politike, ndikuan në krijimin e një kulturë nënshtrimi strukturor dhe ideologjik dhe ushqyen sistemin e dhunës dhe të frikësimit. Thënia se Shqipëria ishte një burg i madh dhe brenda saj kishte shumë burgje të tjera apo se edhe muret kanë veshë apo se nuk kemi patur qytetarë por nënshtetas, individë nën shtetin, janë të gjetura për të identifikuaru tiparet domethënëse të periudhës 1944-1990.

Në tërësi ligjërimi mbi të kaluarën është ligjërim retorik, i bazuar në vlerësime të përgjithshme, kolektive dhe sipërfaqësore. Ka kujtime personale, dëshmi familjare, raportime të ndryshme në media, rezoluta dhe nisma të shumta parlamentare, institucione të reja dhe data përkujtimore, ceremoni dhe aktivitete memoriale. Memoria dhe trajtimi i të kaluarës ishte i paplotë dhe shpesh i fokusuar vetëm tek konsumi ditor i të dhënave dhe replikave midis aktorëve politikë e mediatikë. Institucionit të memories i mungon libri, studimet, raportet referuese, trajtimi profesional dhe cilësor. Përpyekje të veçuara nga ASA/IH, ISKK dhe institucione të tjera, nuk kanë arritur ta plotësojnë boshllëkun e madh në literaturë dhe referim. Për shumicën e studiuesve Shqipëria e periudhës 1945-1990 është një periudhë më shumë e jetuar dhe e komentuar, sesa e studiuar në thellësinë dhe kompleksitetin e saj. Për auditorin e huaj perceptimi dhe informacioni profesional mbi sistemin një partiak në

Shqipëri është gjithashtu sipërfaqësor, i ndërtuar si stereotip me vendet e tjera të të njëjtës përvojë. Në dy rastet botimet profesionale mbi periudhën komuniste janë të pakta dhe si të tillë, nuk kanë arritur ende të mbushin nevojën e madhe të brezave të rinj dhe publikut të interesuar brenda e jashtë Shqipërisë për të pasur një prezantim serioz, të plotë e profesional të të gjithë periudhës në komponentët më të rëndësishëm të saj. Për rrjedhojë, ndonëse të gjithë studiuesit dhe vëzhguesit e jetës politike pranojnë se e kaluara e Shqipërisë në komunizëm ishte rrugë unike, me dallime të mëdha nga vendet e tjera të të njëjtit kamp ideologjik, ajo që ende nuk pranohet është fakti se edhe sjellja e të sotmes ndaj të kaluarës, është gjithashtu unike, me dallime të mëdha nga shumica e vendeve të ish-bllokut lindor.

Më qëllim që të kontribuojmë modestisht në këtë drejtim, Instituti i Studimeve Politike (ISP) inicioi përgatitjen dhe publikimin e këtij botimi të dedikuar shtetit dhe shoqërisë gjatë Shqipërisë komuniste. ISP ftoi në thirrje publike kërkuesit shkencor dhe autorët e interesuar. Botimi nuk paraqet një projekt shterues shkencor, por një prurje shkencore dhe dokumentare. Thirrja nuk sugjeroi një strukturë botimi, duke iu lënë në lirë secilit autor të interesuar të propozojë tema dhe çështje për të cilat posedon ekspertizën e nevojshme. Midis prurjeve të ndryshme, ekipi realizues i ISP përzgjodhi 10 autorë që sollën trajtime më profesionale dhe që dëshmojnë përvojë cilësore në punime shkencore. Botimi u koordinua me kolegen Vera Stojarova, pedagoge dhe eksperte e njohur kërkimore e Universitetit Masaryk në Brno, Çeki. Një parathënie e saj është përfshirë në botim, si reflektim i ndjesive personale në raport me Shqipërinë, por edhe i vlerësimit për strukturën dhe prurjet e këtij botimi. Konkluzioni i saj: *“Ne kurrë nuk mund ta ritregojmë sa duhet realitetin e regjimeve komuniste. Çdo libër që përshkruan jetën në këto regjime, që tregon kontrollin total, censurën, paranojën; policinë sekrete, kampet e përqendrimit, kampet e punës, zhvendosjet dhe ekzekutimet; çdo libër që nxjerr në shesh kultet e personalitetit që i fuqizojnë këto regjime: çdo vepër e tillë është një thesar”* është mesazhi thelbësor i këtij botimi.

Profesori i shkencave politike Ilir Kalemaj e trajton totalitarizmin shqiptar si rast *sui generis* në ish-Europën Lindore. Ai trajton tiparet

kryesore të sistemit komunist në raport krahasues me vende të tjera, bën përshkrimin analitik dhe kritik të Shqipërisë totalitare si dhe trajton elementët e përbashkët dhe të veçuar të praktikave të diktaturës. Në përfundimin e trajtesës së tij autori trajton në mënyrë kritike edhe procesin e destalinizmit, përgjatë tranzicionit demokratik duke arritur në përfundimin se asnjëherë modeli shqiptar i komunizmit nuk arriti të shkonte përtej sistemit të mirëfilltë totalitar dhe të përftonte nuanca të regjimeve të përziera totalitariste-sulltanike.

Studiuesja Irena Nikaj e shikon argumentin e ndarjes ideologjike me përfundimin e LIIB si bazën mbi të cilën u ngrit dhe funksionoi shteti komunist në Shqipëri. Ajo citon me të drejtë teorinë e Arendt mbi “banalitetin e të keqes”, teori e cila i shkon përshtat edhe mënyrës sesi Shqipëria postkomuniste e sheh periudhën 46 vjeçare të sistemit të dhunës brutale ideologjike. Nikaj sugjeron nevojën e dialogut mbi të kaluarën duke krijuar kohezion midis gjeneratave, me bindjen se kombet më të zhvilluara kanë kujtesë historike dhe kulturore, shoqërore dhe politike, dhe kjo i ka ndihmuar të vazhdojnë të lartësojnë përparimin e tyre.

Në kapitullin e shkruar nga unë është synuar të trajtohet edhe përmes të dhënave të përpunuara ilustruese koncepti i përfaqësimit, i vendimmarrjes dhe tiparet kushtetuese e ligjore në Shqipërinë komuniste. Vlerësimi se kemi të bëjmë me një sistem politik të centralizuar dhe të personalizuar, ku udhëheqësi komunist Hoxha dhe Byroja Politika ishin pushteti i vetëm real dhe fuqia reale vendimmarrëse, ku nuk ka ndarje pushteti dhe të drejta dhe ku institucionet kushtetuese dështuan të funksionojnë edhe në kompetencat e tyre ligjore, shoqërohet nga kërkimi i thelluar kryesisht mbi përbërjen e partisë-shtet (PPSH) dhe të Kuvendit Popullor.

Shkrimtari Lazër Stani sjell një dëshmi sa shkencore aq edhe autentike mbi censurën dhe shkrimtarët në diktatorë. Punimi i tij merr vlera të veçanta për shkak të mungesës së studimeve të njëjta të thelluara dhe vlerës së raportit personal me censurën dhe organet ushtruese të saj, me kontrollin shtetëror, por edhe me tiparet kryesore të letërsisë së realizmit socialist. Trajtimi i traumës së censurës në post-diktaturë me

konkluzionin se përballja me sfidën e lirisë në vetvete, ishte dramaturguese pothuajse për të gjithë shkrimtarët e Realizmit Socialist. Ky tipar dhe fenomeni i nostalgjisë janë trajtime origjinale dhe kontribut i veçantë në këtë botim.

Studiuesja Sonila Boçi sjell një punim të plotë kërkimor mbi liritë e “burgosura” me fokus hulumtimin mbi liritë dhe të drejtat të njeriut gjatë viteve të “diktaturës së proletariatit” në Shqipëri. Punimi ka në fokus hendekun e madh që ekzistonte përgjatë totalitarizmit shqiptar, midis atyre lirive dhe të drejtave të garantuara në letër dhe mohimit të tyre në realitetin shqiptar, duke përzgjedhur dy prej të drejtave të mohuara: paprekshmërinë e individit dhe në kufizimin e të drejtave politike. Punimi sjell dëshmi të shumta dokumentare dhe arkivore me vlerësimin se vendimmarrja politike prevalonte mbi logjikën dhe procedurën juridike në të gjitha vendimet arbitrare në shkëlqje të rëndë të të drejtave themelore të individit të garantuara formalisht nga legjislacioni i kohës.

Studiuesi Hasan Bello trajton një prej temave unike për praktikën shqiptare të diktaturës, politikën agresive të PPSH ndaj besimit fetar me fokus periudhën 1944-1967. Pavarësisht se për këtë temë ka disa botime, autori sjell dokumente dhe teza origjinale që lidhen me raste e praktika konkrete të masave ligjore dhe politike antifetare nga regjimi, duke konkluduar se Shqipëria komuniste, anëtare e OKB-së, e shpali botërisht mungesën e tolerancës fetare. Ajo vazhdoi pa u lëkundur rrugën e saj si i pari dhe i vetmi vend ateist në botë, duke sanksionuar këtë dhe në Kushtetutën e vitit 1976.

Profesor Romeo Gurakuqi paraqitet në botim me një studim të thelluar mbi marrëdhëniet e regjimit komunist me SHBA dhe Britaninë e Madhe në periudhën 1944-1946. Autori e bazon kërkimin e vet në traditën e analizës së realizmit politik dhe e shoqëron atë me dokumentacion të pasur arkivor trepalësh, shqiptar, amerikan dhe britanik. Ai e sheh raportin e Hoxhës me dy fuqitë perëndimore në funksion, jo të interesit shtetëror e shoqëror, por të synimit të tij fillimisht në konsolidimin e pushtetit personal dhe më pas, nën kontrollin e plotë sovjetik, në funksion të mbijetesës dhe jetëgjatësisë së pushtetit të tij.

Procesi i sovjetizimit të Shqipërisë (1945-1953) është trajtuar nga studiuesi Dorian Koci, i cili sjell një këndvështrim plotësues mbi studime të mëparshme të së njëjtës problematikë. Periudha kohore e influencës jugosllave në Shqipëri 1945-1947 e shoqëruar më pas me kalimin në ndikimin direkt sovjetik sipas autorit bëri që Shqipëria të kalojë nga statusi i vendit gjysmësatelit, në statusin e vendit satelit. Teza interesante se sovjetizimi i Shqipërisë ishte aq i thellë saqë mbijetoi gjatë edhe pas prishjes së marrëdhënieve midis dy vendeve, është edhe argument domethënës për rrugëtimin unik stalinist që zgjodhi udhëheqja e PPSH.

Studiuesi Kastriot Dervishi vjen në këtë botim me një dokumentim profesional të bazës ligjore kryesore mbi të cilat janë bazuar krimet kundër shtetit në legjislacionin e shtetit komunist. Klasifikimi i veprave penale, ligjeve dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre dhe sidomos ilustrimet rast pas rasti me ngjarje, emra, gjyq dhe vendimmarrje konkrete, ofron një pamje të plotë të mekanizmit të dhunës shtetërore të bazuar në kriteret ideologjike dhe luftës së klasave.

Studiuesja më e re në botim, Alkida Lushaj, trajton fenomenin e ndërtimit të “njeriut të ri”, një praktikë e huazuar nga ndikimet e revolucionit kulturor kinez. Punimi sjell aspekte të ndryshme politike dhe sociale me ndikim në këtë proces, me vlerësimin se produkti ideologjik i “njeriut të ri” përfaqësonte qytetarin dhe shoqërinë e nënshtruar, të bindjes dhe turmës, pa identitet dhe pa liri mendimi e veprimi, duke zëvendësuar individin me kolektiven dhe stimuluar besnikërinë pa kushte, konformizmin dhe apatinë shoqërore.

Botimit i munguan trajtesat në fushën e ekonomisë, të cilat gjithashtu mungojnë në tërësi edhe në arkivin e botimeve të tranzicionit. Në funksion të përballjes me këtë pengesë dhe nevojës për njohje të këndvështrimeve alternative mbi zhvillimin ekonomik në Shqipërinë komuniste ne vendosëm të përfshijmë në botim një pjesë nga një libër i autorit Hasan Banja, një prej autorëve kryesore mbi ekonominë socialiste përpara viteve '90. Trajtesa e tij merret me problemet dhe pengesat e hapura në politikën e industrializimit të vendit dhe pasqyron kryesisht vlerësime pozitive dhe më pak negative mbi këtë problematikë.

Si njëri prej editorëve përgjegjës për këtë botim dhe me vlerësim të përbashkët me editoren Stojarova, falënderoj autorët që iu përgjigjën thirrjes dhe kontribuan gjatë pesë muajve të fundit, pavarësisht vështirësive që krijoi për të gjithë situata e pandemisë së COVID-19, si dhe dy redaktorët, Gëzim Zilja dhe Nevila Zenelaj. Falënderimi i veçantë i takon programit “Transition” të MPJ dhe ambasadës së Republikës së Çekisë në Tiranë, me të cilën me interes dhe dashamirësi kemi rakorduar ecurinë e procesit për realizimin e këtij botimi.

Afrim Krasniqi